

# MAHLE



Filtra CleanLine

Veçimi efikas i ujit

# Filtrat CleanLine: një koncept inovativ për rezultate të besueshme



*Uji në naftë është një rrezik i vazhdueshëm për komponentët e prekur të një automjeti. Ai ndryshk pjesët metalike dhe zvogëlon aftësinë lubrifikuese të karburantit, gjë që mund të çojë në bllokimin e pompës së karburantit. Me filtrin e ri vidhues CleanLine, MAHLE ofron një mbrojtje perfekte për automjetet komerciale me motor me naftë.*

MAHLE CleanLine është një sistem filtri inovativ, me performancë të lartë dhe i lehtë për t'u zëvendësuar. Ky filtër për veçimin e ujit dhe të grimcave arrin performancën më të lartë gjatë gjithë jetës së tij të shërbimit. Pika kulminante është varianti me dy nivele për vendet ku cilësia e naftës është e dobët. Këtu, heqja e papastërtive (niveli 1) dhe e ujit (niveli 2) kryhet veçmas nga njëra-tjetra, gjë që çon në një pastrim veçanërisht efikas.

### **Në të gjithë botën do të jenë në dispozicion tri versione:**

- CleanLine me 2 nivele, me rezervuar uji të integruar (i disponueshëm vetëm në Amerikën e Jugut)
- CleanLine me 2 nivele pa rezervuar uji (i disponueshëm në EMEA)
- CleanLine me 1 nivel pa rezervuar uji (i disponueshëm në EMEA)

# Filtrat CleanLine: Detaje rreth funksionit


## Veçim më efikas i ujit, më pak ndotje, performancë më e mirë në të gjitha fushat.

Sistemet tradicionale të filtrave funksionojnë me një nivel. Megjithatë, rezultatet e provës tregojnë se kur ndotet karburanti, shkalla e veçimit të ujit të këtyre sistemeve bie nga 93% në më pak se 20%. Kjo është arsyeja pse filtri CleanLine funksionon sipas parimit me dy nivele.

### Niveli 1: Filtrimi i naftës nga ndotësit dhe grumbullimi i pikave të ujit

### Niveli 2 : Veçimi i pikave të grumbulluara të ujit nga karburanti i filtruar

Duke bllokuar papastërtitë në nivelin e parë të filtrit, uji mund të veçohet në mënyrë më efektive në nivelin e dytë. Kjo siguron veçimin maksimal të ujit gjatë gjithë intervalit të servisit. Përveç kësaj, falë ndarjes së dy niveleve të filtrit, veçohen madje edhe pikat më të vogla të ujit.



# Filtrat CleanLine: Një krahasim



Në krahasim me konkurrencën, CleanLine rezulton me shkallën më të lartë të veçimit të ujit gjatë gjithë jetëgjatësisë së filtrit: mbi 93% kur është e re. Madje edhe pas 30.000 kilometrash, një 70% e konsiderueshme e ujit është akoma e veçuar. Produktet e konkurrencës, pas të njëjtit kilometrazh, këtë gjë e arrijnë me më pak se 20%. Për më tepër, kapaciteti filtrues i pluhurit të CleanLine është dukshëm më i lartë se ai i filtrave tradicionalë.

Gjendja e filtrit	Shkalla e veçimit të ujit në sistemet tradicionale me një nivel	Shkalla e veçimit të ujit me filtrin CleanLine me dy nivele
Filtër i ri	Mbi 93 %	Mbi 93 %
Filtër i përdorur në kushtet e funksionimit	Deri në 20%	Mbi 70 %



## Filtër Clean Line veçon më shumë ujë nga karburanti naftë

Superioriteti i filtrimit me dy nivele përkundrejt sistemeve tradicionale bëhet gjithnjë e më i dukshëm me kalimin e kohës.



■ Konkurenti ■ CleanLine Përbajtja e ujit (ppm)




## Përparësitë e filtrit CleanLine

- Veçim maksimal i ujit dhe kapacitet maksimal filtrues i pluhurit gjatë gjithë jetëgjatësisë
- Shkallë e lartë efikasiteti
- Mbrojtje më e mirë e sistemit të injektimit
- Kursim në kostot e shërbimit të mirëmbajtjes së injektorëve dhe të pompave të karburantit
- Karter plastik i fuqishëm
- Kosto më e ulët për kilometër
- Multiplikim për disa përdorime, pra më pak ngarkesë dokumentimi
- Zëvendësim i lehtë i filtrit dhe përdorim i rezervuarit ekzistues të ujit

NIVELI 1

NIVELI 2



# Përmbledhje e modeleve

Filtra karburanti MAHLE	MAHLE CleanLine me 1 nivel	MAHLE CleanLine me 2 nivele	Prodhuesi	Modeli	Referenca MANN-FILTER	Referenca Hengst
KC 249D	KC 648D	KC 624D	DAF Scania	XF 105 Seria 4	WK 1060/3 x	H7090WK30
KC 377D			New Holland	Seria CR/CX/TX	WK 1142/2 x	n. v.
KC 378D			Kamionë Volvo	FM12 dhe FM9	WK 1060/5 x	H7090WK10
KC 379D			New Holland	Seria TC/TR/TX	WK 1142 x	H7090WK10
KC 374D	KC 645D	KC 633D	IVECO Kamionë Renault	Stralis/Strator/Trakker Seria D/C	WK 1070 x	H7090WK10
KC 384D			Kamionë Renault Kamionë Volvo	Midlum II/Premium Distribution FE II dhe FL II	WK 1040/1 x	H7062WK30
KC 429D	KC 646D	KC 634D	Kamionë Renault Kamionë Volvo	Magnum/Premium Distribution FH/FH II, FM	WK 11 001 x	H328WK
KC 491D			Kamionë Renault Kamionë Volvo	Magnum/Premium Distribution FH/FH II, FM	WK 10 006 z	H392WK
KC 296D	KC 652D	KC 629D	DAF	New XF, New CF, XF 105, XF 95	PL 420 x	H710WK
KC 505D			Mercedes-Benz KAMAZ	Actros MP4, Arocs, Antos, Atego III Seria 5000/6000	PL 420/7 x	H356WK
KC 200	KC 697D	KC 699D	Mercedes-Benz	Actros MP2/MP3	WK 1080/7 x	H701WK
KC 375D			Mercedes-Benz Scania	Actros MP2/MP3, Atego II Seria G/P/R	WK 1080/6 x	H7160WK30
KC 430D			Caterpillar	Diverse	WK 1175 x	H7120WK10

MAHLE Aftermarket GmbH  
Pragstraße 26 - 46  
70376 Stuttgart/Gjermani  
Telefon: +49 711 501-0  
[www.mahle-aftermarket.com](http://www.mahle-aftermarket.com)  
[www.mpulse.mahle.com](http://www.mpulse.mahle.com)

MAHLE Insider



mahled-092/01..2021/SQ